

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët: Kymete Kicaj dhe Teuta Krusha, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarëve I. B. nga Prizreni, R. E. nga Prizreni, I. M. nga Prizreni, H. M. nga Prizreni, S. B. nga Prizreni, S. B.1 nga Prizreni, Sh. Sh. nga fshati B. , Komuna e Dragashit, N. D. – A. nga Prizreni dhe V. H. nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.l. lidhur me nenin 31 të KP, si dhe i akuzuari V. H. për shkak të veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare nga neni 422 par.l. të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së PSH në Prizren PP.nr.210/14 të datës 21.09.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarëve dhe mbrojtësve të tyre av.E. G. dhe F. P. , më datën 06.06.2016, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**I.I. B. ,** nga i ati B. dhe e ëma H. – e lindur H. , i lindur më ... në fshatin R. të H. Komuna e Gjakovës, tani me banim në Prizren në rrugën “Z. S.” nr.... , e ka të kryer fakultetin ekonomik, punon në Shkollën e mesme ekonomike “ I. P. ”, i martuar, i ati i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shteta si Republikës së Kosovës.

**II.R. E. ,** nga i ati A. dhe e ëma R. – e lindur Rr. , i lindur më ... në fshatin N. S. , me vendbanim në Prizren në rrugën “S.” nr. ... , e ka të kryer fakultetin ekonomik, profesor në Shkollën ekonomike “ I. P. ” në Prizren, i martuar – i ati i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, boshnjak – shtetas i Republikës së Kosovës.

**III.I. M. ,** nga i ati Rr. dhe e ëma E. – e lindur H. , e lindur më ... në Prizren ku edhe tani jeton, në rrugën “ A. K. ” hyrja . , nr.. , e ka të kryer fakultetin ekonomik, profesoreshë në shkollën ekonomike “I. P. ” në Prizren, e martuar – e ëma e tre fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare – shtetase e Republikës së Kosovës.

**IV.H. M. ,** nga i ati A. dhe ëma H. – e lindur K. i lindur më ... në fshatin K. , Komuna e Dragashit, me vendbanim në Prizren në rrugën “ Xh. B. ” nr. .. , e ka të kryer fakultetin e bujqësisë, profesor në Shkollën ekonomike, “I. P.” në Prizren, i

martuar – i ati i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

**V.S. B.** , nga i ati E. dhe e ëma S. – e lindur K. , i lindur më ... në fshatin Zh., me vendbanim në Prizren në rrugën “K.” PN, e ka të kryer fakultetin ekonomik, profesor në Shkollën ekonomike “I. P.” në Prizren, i martuar – i ati i 5 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

**VI.S. B. 1** , nga i ati S. dhe e ëma H. – e lindur K. , i lindur më ... në fshatin B. , Komuna e Dragashit, me vendbanim në Prizren në rrugën “ K. i L.” PN, e ka të kryer fakultetin e mbrojtjes, profesor në Shkollën ekonomike “I. P.” në Prizren, i martuar – i ati i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i republikës së Kosovës,

**VII.SH. SH.** , nga i ati Y. dhe e ëma A. – e lindur R. , i lindur më ... në fshatin B. , Komuna e Dragashit, ku edhe tani jeton, e ka të kryer fakultetin ekonomik, profesor në Shkollën ekonomike “I. P.” në Prizren, i martuar – i ati i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shteta si Republikës së Kosovës.

**VIII.N. D. – A.** , nga i ati R. dhe e ëma Xh. - e lindur L. , e lindur më ..., me banim në Prizren në rrugën “S. Ç.” nr. .. , e ka të kryer fakultetin ekonomik, profesor në Shkollën ekonomike “I. P.” në Prizren e martuar – e ëma e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare – shtetase e Republikës së Kosovës.

**IX. V. H.** , nga i ati M. dhe e ëma F. – e lindur A. , i lindur më ..., me banim në Prizren në rrugën “Z. P. ” nr.../.. , e ka të kryer fakultetin e kimisë, profesor në shkollën e mesme ekonomike “I. P.”, i martuar - i ati i një fëmiju, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konformë nenit 364 par.1.p.l.3, të KPP të akuzuarit I. B. , R. E. , I. M. , H. M. , S. B. , S. B. 1 , Sh. Sh. , N. D. – A. dhe V.H. .

## **LIROHEN NGA AKUZA**

Se më datën 16.09.2013 në cilësi të personave zyrtar, si anëtarë të Këshillit drejtues të Shkollës së mesme ekonomike “I. P.” në Prizren në kundërshtim me nenin 11 par.1. dhe par.2. 13 të Udhëzimit administrativ mbi aktivitetet jashtëshkollore me nr. 27/2013, kanë marrë vendim për realizimin e ekskurzionit, në këtë mbledhje të këshillit drejtues haptas kanë favorizuar kompaninë turistike “B. R.” ndërsa Drejtori i Këshillit të shkollës së mesme I. B. është autorizuar për lidhjen e kontratës, përzgjedhjen e ofertuesit e kanë bërë para hapjes dhe vlerësimit të ofertave të kompanive turistike që janë paraqitur në tender duke i mundësuar kompanisë turistike “B. R.” ti dërgon në ekzkurzion 461 nxënës, ashtuqë veprojnë në kundërshtim me udhëzimin administrativ nr.27/2013 pikërisht dispozitën e nenit 12 dhe 13 e që kompanit konkurrese “Zh. t.” , “A.” dhe kompania “Sh.” të gjitha me seli

në Prizren i eliminojnë nga gara për tender, pa bazë ligjore, meqenëse fituesin e tenderit – kompaninë turistike “B. R.” me seli në Prizren e kishin shpallur para hapjes së ofertave, ashtuqë 461 maturantë janë dëmtuar me nga 23 Euro, e që dëmi i përgjithshëm arrinë 10.603 Euro, duke i shkelur rëndë të drejtat e kompanisë “Sh.” nga Suhareka, meqenëse nuk është zbatuar kriteri i ftesës për ofertë për përzgjedhjen e kompanisë turistike më të përshtatshme ekonomike.

-Këso dore në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1.lidhur me nenin 31 të KP.

Konformë nenit 364 par.1.p.l.3, të KPP i akuzuari V. H.

### **LIROHET NGA AKUZA**

Se në cilësi të drejtorit të Shkollës së mesme “I. P.” në Prizren më datën 03.10.2013 në emër të Shkollës së mesme ekonomike të lartë “I. P.” në Prizren me kompaninë turistike “B. R.” nga Prizreni të cilën e përfaqëson I. U. lidh kontratën me nr. të protokolit ... / .. përmes së cilës sipas nenit 4 precizohet çmimi prej 108 Euro për shkuarjen në ekskurzion të kësaj shkolle edhe sipas ftesës për ofertë të publikuar në gazetën “Kosova Sot” afati për shqyrtimin e ofertave ka qenë deri më datën 03.10.2013, në atë mënyrë që i tejkalon kompetencat duke i shkaktuar dëm kompanisë turistike “Sh.” nga Suhareka dhe seriozisht i shkel të drejtat e kësaj kompanie.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KP.

Shpenzimet procedurale bijnë në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti për krime të rënda, kësaj gjykate ia ka parashtruar aktakuzën PP.nr.210/14 të datës 21.09.2015 kundër të akuzuarëve I. B. nga Prizreni, R. E. nga Prizreni, I. M. nga Prizreni, H. M. nga Prizreni, S. B. nga Prizreni, S. B. 1 nga Prizreni, Sh. Sh. nga fshati B. , Komuna e Dragashit, N. D. – A. nga Prizreni dhe V. H. nga Prizreni, për shak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. lidhur me nenin 31 të KP, si dhe i akuzuari V. H. për shkak të veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare nga neni 422 par.1. të KP. Në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit Mehdi Sefa ka ngelur në

tërësi pranë aktakuzës duke cekur se të akuzuarit në cilësinë e personave zyrtar – anëtarë të Këshillit drejtues të Shkollës “I. P.” dhe të komisionit të ngushtë përzgjedhës duke e shfrytëzuar autoritetin zyrtar e favorozijnë kompaninë “B. R.” me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore duke i shkelur kriteret e ofertës si kompani më e përshtatshme ekonomike me ç rast shkaktojnë një dëm 461 nxënësve në shumën prej 10.603 Euro. Poashtu i akuzuari V.H. në cilësinë e Drejtorit të shkollës “I. P.” edhe pse ftesa për ofertë ka qenë deri më datën 03.10.2013 në ora 14:00, pas hapjes së ofertuesve nënshkruan kontratën për ekskurzion me kompaninë “B. R.” duke shkelur njoftimin e shkollës ku ofertuesve tjerë të cilët kanë humbur ofertën për tender iu ipet mundësia e ankesës dy ditore. Propozon që të njejtit të shpallen fjator sipas ligjit dhe se me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata përveq rrethanave rënduese ti ketë parasysh edhe rrethanat lehtësuese se të gjithë të akuzuarit janë profesor, deri më tani të padënuar dhe se kanë pas qëndrim korrekt para gjykatës.

I akuzuari I. B. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka dorëzuar në formën e shkruar, të cilën edhe e ka elaboruar gojarisht duke cekur se me asnjë provë nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Si komisioni i shkollës kanë zgjedhur ofertën më ekonomike për nxënësit e që ka qenë edhe kriteri i konkursit të shpallur nga DKA dhe se në këtë përzgjedhje nuk i është shkaktuar asnjë dëm as nxënësve e as prindërve, andaj ka propozuar që në mungesë të provave të merret aktgjykim lirues.

I akuzuari R. E. në fjalën përfundimtare ka theksuar se nuk e ndien vehten fajtor sepse gjatë shqyrtimit të ofertës e ka respektuar ligjin respektivisht udhëzimin administrativ dhe e kanë zgjedhur ofertuesin më të përshtatshëm ekonomik. Përveç kësaj ka patur kujdes që për komunitetet të iu ofrohet siguria gjatë ekskurzionit në Shqipëri dhe se këtë siguri iu ka mundësuar agjensioni “B. R.”. Prindërit dhe nxënësit kanë qenë të kënaqur dhe se nuk ka patur asnjë vërejtje as nga nxënësit e as nga prindërit.

E akuzuara I.M. në fjalën përfundimtare poashtu ka deklaruar se nuk e ndien vehten fajtorë dhe se me veprimet e veta nuk ka shkelur ligjin e as nuk e ka keqpërdorur pozitën e vet. Gjatë përzgjedhjes së kompanisë “B. R.” si anëtare e komisionit në cilësi të prindërit e kanë përzgjedhur agjensinë më të volitshme ekonomike, pasiqë referenca e të gjithë anëtarëve të bordit së bashku me drejtorin dhe referenca e nxënësve kanë qenë për kompaninë “B. R.” duke u bazuar në referencat më të favorshme nga vitet paraprake. Ka propozuar që trupi gjykues ta liroi nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. M. av. E. G. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar në formën e shkruar të cilën gjatë shqyrtimit e ka elaboruar edhe gojarisht duke cekur se akuza është e mbështetur në provat e papranueshme dhe jo bindëse dhe se ka dëmtuar mjaftë shumë imazhin e të akuzuarit pasiqë në ofertën publike janë elaboruar edhe përparsitë e shqyrtimit të ofertave nga ana e komisionit dhe se duke u bazuar në kushtet e ofruara nga “B. R.” e që kompanitë tjera nuk i

kanë plotësuar, e kanë zgjedhur atë kompani pasiqë ka qenë më komod, ka ofruar vizita pa pagesë disa vende turistike dhe nxënësve të cilët nuk kishin kushte ekonomike për të paguar, iu është mundësuar shkuarja pa pagesë. Ka propozuar që i akuzuari të lirohet nga akuza pasiqë nuk është provuar se e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari S. B. në fjalën përfundimtare ka theksuar se nuk e ndien vehten fajtor pasiqë si anëtar i këshilit të shkollës ka vepruar konformë ligjeve dhe dispozitave në fuqi. Ka marrë pjesë vetëm në mbledhjen e parë për ofertat e cila më vonë është anuluar dhe se më tej nuk ka qenë pjesë e procedurave të mëtejme.

I akuzuari S. B. 1 në fjalën përfundimtare poashtu ka cekur se nuk e ndijen vehten fajtor dhe ka propozuar që të lirohet nga akuza.

I akuzuari Sh. Sh. në fjalën përfundimtare ka theksuar se nuk e ndien vehtin fajtor sepse ka marrë pjesë vetëm në mbledhjen e parë e cila mbledhje është anuluar nga DKA-ja dhe se nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e tjera. Andaj, ka propozuar që të lirohet nga akuza.

E akuzuara N. D. - A. , poashtu ka theksuar se nuk e ndien vehten fajtores pasiqë ka marrë pjesë vetëm në mbledhjen e parë e cila është anuluar nga DKA-ja dhe se në mbledhjet tjera fare nuk ka marrë pjesë. I ka propozuar trupit gjykues që ta liroi nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit V. H. avokat F. P. gjykatës fjalën përfundimtare ia ka parashtruar në formën e shkruar, të cilën e ka elaboruar edhe gojarisht duke cekur se me asnjë provë gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari V. H. ka tejkalar kompetencat e tija ose nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare të tij, pasiqë sipas vendimit të Drejtorisë komunale të arsimit për delegimin e kompetencave tek drejtorët e shkollave dhe sipas këtij vendimi kompetent për përzgjedhjen e një ofertuesi ka qenë Këshilli drejtues i shkollës dhe se ky këshill pastaj e ka formuar komisionin prej 5 anëtarëve për vlerësimin e ofertuesit më të përshtatshëm ekonomik. Më pastaj komisioni e ka përzgjedhur kompaninë turistike "B. R." e cila ka qenë më e përshtatshme dhe se pas përgjedhjes së kësaj kompanie i mbrojturi i tij në cilësinë e drejtorit të shkollës dhe kryetar i Këshillit të shkollës kanë nënshkruar kontratën me nr. .../.. të datës 04.10.2013. Në rastin konkret është përzgjedhur kompania më e përshtatshme ekonomike për shkak të kushteve të ofruara, si akomodimi në hotel, performanca, siguria e nxënësve, më shumë se 65 nxënës kanë udhëtuar gratis, muzika, mjeku etj. Nuk është vërtetuar se V. H. i ka tejkalar kompetencat duke i shkaktuar dëm kompanisë turistike "Sh.". Kontrata nuk është lidhur para hapjes së ofertave por pas hapjes së ofertave e që ky fakt vërtetohet me datën e nënshkrimit të kontratës -04.10.2013, ndërsa sipas ftesës për ofertë data e hapjes ka qenë 03.10.2013. Andaj, ka propozuar që të lirohet nga akuza.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje gjykata gjatë procedurës së provave ka ndëgjuar në cilësi të dëshmitarit të dëmtuarin E. V. i cili ka ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në Prokurorinë e Shtetit në procesverbalin Hp.nr.210/14 të dtës 02.07.2015 dhe se gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 01.04.2016 ka deklaruar se është eliminuar padrejtësisht nga konkurenca me ndikimin e drejtorit V. H. dhe të Kryetarit të këshillit I. B. . Zyrtarisht nuk është informuar për përzgjedhjen e kompanisë fituese dhe se personalisht nuk ka marrë pjesë në hapjen e ofertave, ndërsa nuk i kujtohet se a ka marrë pjesë ndonjë bashkëpunëtorë i tij apo jo. Si i dëmtuar ka parashtruar kërkesë pasuroro-juridike në vlerë prej 15.000 Euro.

Dëshmitari N. Ç. në deklaratën e dhënë në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.05.2016 ka ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori në procesverbalin Hp.nr.210/14 të datës 25.06.2015 dhe se gjatë shqyrtimit në mes tjerash ka deklaruar se pas kërkesës së shkollave në DKA për dhënjen e pëlqimit për organizimin e ekskurzionit është bërë edhe oferta e parë e cila është anuluar për të gjitha shkollat e mesme për arsye se nuk është përfshirë një kërkesë e Ministrisë së transportit dhe të tregëtisë. Për ofertën e dytë për shkak të konfliktit të interesit të tij me firmat konkuruuese "Sh." dhe "A.", duke e shfrytëzuar të drejtën i ka autorizuar drejtorët e të gjitha shkollave të mesme që të vazhdojnë me procedura sipas udhëzimit administrativ të lëshuar nga MASH-ti. Me rastin e shqyrtimit të ofertave drejtori ka zgjedh këshillin – komisionin për shqyrtimin e ofertave. Sipas tij nuk është dëmtuar as DKA-ja as shkolla pasi që paratë janë të nxënësve dhe se zakonisht pas realizimit të ekskurzionit shkollat paraqesin një raport DKA-së si njoftime. Sa është në dijeni gjatë realizimit të ekskurzionit nga shkolla në fjalë nuk ka patur kurrfarë ankese.

Në bazë të kërkesës për ekskurzion me nr. ... të datës 13.09.2013 drejtori i shkollës – këtu i akuzuari V. H. dhe kryetari i këshillit – këtu i akuzuari I. B. kanë bërë kërkesë që për nxënësit maturatë të organizohet ekskurzioni 5 ditor në Shqipëri.

Në bazë të pëlqimit të datës 13.09.2013 me referencë ... / .. të nënshkruar nga drejtori i arsimit në Prizren N. Ç. është lejuar nisja e procedurave për realizimin e ekskurzionit për maturanët dhe kujdestarët e klasave të SHME "I. P." në Prizren dhe se është obliguar drejtori i shkollës që të veproi në bazë të udhëzimit administrativ nr.27/13 të datës 18.06.2013.

Nga procesverbali i datës 16.09.2013 vërtetohet se është marrë vendim se këshilli i shkollës në mbledhjen e vet të mbajtur më datën 16.09.2013 ka marrë vendim që për nxënësit maturantë të organizohet ekskurzioni 5 ditor në Shqipëri.

Në bazë të vendimit të datës 18.09.2013 të nënshkruar nga drejtori i shkollës V. H. vërtetohet se është marrë vendim për organizimin e ekskurzionit për nxënësit maturantë dhe nisja të bëhet më datën 05.10.2013.

Në bazë të ofertave për ekskurzion të kompanisë “Sh.” “Zh. T.” , “A. “ dhe kompanisë “B. R.” vërtetohet se ofertuesit e lartëcekur kanë ofruar shërbimet e tyre për maurantët që do të udhëtojnë për ekskurzion me itinerarin e cekur.

Në bazë të procesverbalit me datë 23 - mungon data e saktë dhe ora e mbajtjes së procesverbalit është bërë hapja e ofertave.

Nga lista për hapjen e ofertave e datës 23.09.2013 vërtetohen çmimet e ofruara dhe agjencitë turistike konkurrese “B. R.” , “A.” , “Sh.” dhe “Zh. T.” .

Nga vendimi i datës 24.09.2013 me nr. të referencës ... / .. drejtori i DKA-së N. Ç. ka marrë vendim që të anulohen të gjitha ftesat për oferta për realizimin e ekskurzioneve dhe se të përsëriten ftesat për oferta për të gjitha shkollat e mesme.

Në bazë të vendimit të datës 01.10.2013 drejtori i DKA-së N. Ç. e ka autorizuar drejtorin e SHME “I. P.” dhe V. H. si dhe këshillin drejtues të shkollës që ta bëjnë përzgjedhjen e agjencionit turistik për realizimin e ekskurzionit me maurantët.

Në bazë të ftesës për ofertë të shpallur në shtyin ditor – është shpallur ftesa për ofertë për ekskurzionin e maurantëve të SHME “I. P.” në Prizren si dhe janë paraparë kushtet që duhet ti plotësojnë ofertuesit dhe se afati i paraqitjes ka qenë deri më datën 03.10.2013 në ora 14:00, ndërsa hapjen e ofertave do ta bëjë komisioni sipas udhëzimit administrativ 27/13 me datën 03.10.2013 në ora 14,30 minuta, në ambientet e Drejtorisë komunale të arsimit.

Nga procesverbali i mbledhjes së komisionit për përzgjedhjen e kompanisë turistike për realizimin e ekskurzionit drejtori i shkollës V.H. së bashku me komisionin e zgjedhur në përbërje prej I. B. kryetar, R. E. anëtar, H. M. anëtarë, I. M. anëtarë, dhe A. H. – nxënëse kanë vendosur që realizimin e ekskurzionit ta bëjë kompania “B. R.”, pasi që përveç komisionit të pëlqimit për këtë kompani kanë qenë edhe nxënësit dhe prindërit e tyre.

Nga lista për hapjen e ofertave e datës 03.10.2013 vërtetohet se kompanitë ofertuese i kanë ofruar ofertat – çmimet e tyre për ekskurzionin që do të organizohet dhe se “Sh.” ka ofruar ofertë prej 85 Euro, ndërsa kompania “B. R.” ofertën prej 108 Euro.

Në bazë të kontratës për transportimin e nxënësve me nr. të protokolit ... / .. është lidhur kontrata në mes të shkollës së mesme ekonomike të lartë “I. P.” të përfaqësuar nga drejtori i shkollës V. H. dhe kompanisë turistike “B. R.”, e cila kontratë është nënshkruar më datën 04.10.2014 nga ana e drejtorit të shkollës V. H. , përfaqësuesit të kompanisë “B. R.” dhe kryetarit të këshillit drejtues.

Nga raporti i ekskurzionit vërtetohet se këshilli organizues i ekskurzionit në përbërje prej I. B. , A. Sh. , B. G. , K. K. dhe Z. B. kanë përpiluar raportin pas këthimit nga ekskurzioni me përshkrim të vizitave të cilat i kanë bërë.

Nga procesverbali i datës 07.09.2013 i mbledhjes me kujdestarët e klasave të XII-ta dhe të XIII-ta, është marrë vendim që të bëhen pregaditjet për ekskurzion.

Nga shkresa për “obligimet e shkollës” të nënshkruar nga drejtori i shkollës V. H. cekën disa obligime të drejtorit dhe kujdestarit të klasës gjatë realizimit të ekskurzionit.

Në bazë të njoftimit të datës 03.10.2013 me nr. të referencës 929/13 vërtetohet se komisioni vlerësues e ka përzgjedhë kompaninë “B. R.” për organizimin e ekskurzionit dhe se kompanitë e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 2 ditëve nga dita e njoftimit.

I akuzuari I. B. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ka qenë përfaqësues i prindërve dhe se sipas udhëzimit administrativ ka qenë edhe kryetar i këshillit i cili ka vendosur për datën e nisjes, për itinerarin dhe çmimin. Kompania “B. R.” është përzgjedhur në bazë të ofertës së shpallur në gazetën “K. S. “ dhe se kriteri kryesor ka qenë siguria e nxënësve si dhe oferta më ekonomike e jo më e lira. Poashtu kompania “B. R.” ka ofruar sigurinë e nxënësve nga se akomodimi ka qenë vetëm në një hotel ndërsa ofertuesi i dytë “Sh.” ka ofruar që nxënësit të vendosen në 2 – 3 hotele, të shpërndahen gjë që kjo nuk ka qenë e sigurt për nxënësit. Kriter tjetër ka qenë edhe oferta që ka ofruar për fëmijët për invalidët e luftës, fëmijët e varfër dhe ata me asistencë sociale që të udhëtojnë falas dhe se kjo ka qenë arsyeja e përzgjedhjes së kësaj kompanie. Poashtu kompania “B. R.” ka ofruar vizitat në monomentet historike pa pagesë, dhe se gjatë shkuarjes dhe kthimit të gjithë nxënësit kanë pasur edhe nga një sendviç, e që kompanitë tjera nuk kanë ofruar. Kompanitë tjera janë njoftuar se nuk janë përzgjedhur nëpërmjet njoftimit të shpallur në tabelën e njoftimeve të shkollës dhe se ka ekzistuar afati dy ditor për ankesa, mirëpo, nuk ka patur kurrfarë ankese as nga ofertuesit të cilët nuk janë përzgjedhur as nga prindërit e as nga nxënësit. Poashtu, në vitin 2013 ka qenë hera e parë që ka udhëtuar edhe komuniteti boshnjak dhe se kjo është bërë vetëm për shkak të sigurisë të cilën e ka ofruar kompania “B. R.” .

I akuzuari R. E. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori dhe se ka qenë në këshillin e shkollës nga minotitetet dhe ka qenë anëtar i këshillit drejtues të shkollës. I kujtohet se është përzgjedhur kompania “B. R.” dhe se i njëjti ka dhënë arsyet se pse është përzgjedhur kjo kompani dhe atë për shkak të referencave të mira pasi që ka ofruar siguri më të mirë për nxënësit e komunitetit boshnjak dhe se prindërit kanë insistuar që ti lëshojnë fëmijët vetëm nëse sigurimi do të jetë në nivel. Sa i përket çmimit mendon se kompania ka ofruar çmimin prej 108 Euro ndërsa “Sh.” 85 Euro, mirëpo me ofrimin e këtij çmimi nga ana e kompanisë “Sh.” kanë menduar se diçka nuk është diçka në rregull sipas kushteve të



ekskurzionit dhe rregullave të tregut. Kjo nga arsyeja se kompania "Sh." ka ofruar akomodim në hotele të ndryshme e jo në një hotel dhe se pas përfundimit të ekskurzionit nuk ka patur ankesa as nga prindërit e as nga nxënësit.

E akuzuara I. M. në mbrojtjen e vet ka deklaruar se është përzgjedh në komision në cilësinë e prindërit pasiqë djali i saj ka qenë nxënës. Është përzgjedhë kompania "B." pasiqë ka patur referenca më të mira nga përvoja e viteve të kaluara, siguria ka qenë më e plotë, organizimi ka qenë më i mirë, atë vit kanë qenë dy gjenerata klasa e XII dhe XIII akomodimi ka qenë në rregull, ushqimi në rregull dhe se nuk ka patur kurrfarë ankesa nga asnjë nxënës apo prind.

I akuzuari H. M. në mbrojtjen e vet ka deklaruar se si kriter ka qenë oferta më e favorshme ekonomike, se ofertuesi i ka plotësuar kushtet sipas anëtarëve të këshillit drejtues dhe se është përzgjedhur kompania "B." me arsyetim se ka ofruar që të udhëtojnë pa pagesë nxënësit me gjendje të vështirë, nxënësit e dëshmorëve, veteranëve dhe të gjithë kategorive të luftës, performanca në krahasim me kompanitë tjera ka qenë më e favorshme dhe se poashtu ka ofruar gjatë ekskurzionit vizita nëpër qytete dhe monumente historike gratis.

I akuzuari S. B. në mbrojtjen e vet ka deklaruar se ka qenë anëtar i këshillit drejtues në cilësinë e prindërit, në komisionin e ngushtë përzgjedhës i cili e ka bërë përzgjedhjen e komisionit dhe se me rastin e përzgjedhjes së komisionit të gjitha kompetencat kanë kaluar tek ky komision. Konsideron se nxënëseti nuk janë të dëmtuar bazuar në atë se nuk kanë patur ankesë as nga nxënësit e as nga prindërit dhe se me rastin e përzgjedhjes është përzgjedhë kompania e cila ka ofruar sigurinë e nxënësve, ka patur referenca pozitive dhe ka ofruar beneficione tjera dhe se kompania fituese ka ofruar udhëtimin pa pagesë të nxënësve me raste sociale, të fëmijëve të dëshmorëve, kujdestarëve të klasës si dhe ka bërë sigurimin e muzikës gjatë qendrimit.

I akuzuari S. B. 1 në mbrojtjen e vet ka deklaruar se ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në Prokurorinë e Shtetit në Prizren duke cekur se ka qenë anëtar i këshillit drejtues në cilësinë e prindit dhe se kjo ka qenë në ofertën e parë e cila është anuluar nga drejtoria e arsimit dhe se nuk ka marrë pjesë në ofertën e dytë pasiqë ka qenë i sëmurë.

I akuzuari Sh. Sh. në mbrojtjen e vet ka ngelur pranë deklaratës së dhënë në PSH më datën 19.06.2015 duke shtuar se ka qenë anëtar i këshillit drejtues ku kanë qenë 8 anëtarë dhe një përfaqësues i nxënësve dhe se në mbledhjen e mbajtur është vendosur për datën e saktë, itinerarin e ekskurzionit dhe përafërsisht çmimi i ofertave bazuar në vitet paraprake prej 108-110 Euro dhe se kjo ofertë është anuluar nga DKA-ja pasiqë janë shkel disa rregulla procedurale dhe se nuk ka qenë në mbledhjet tjera.

I akuzuara N. D. A. në mbrojtjen e vet ka deklaruar se ka qenë anëtare e këshillit të shkollës, mirëpo, nuk ka qenë anëtare e komisionit për hapjen e ofertave

dhe përzgjedhjen e ofertuesit dhe se nuk ka qenë pjesë e mbledhjes tjetër kur është bërë hapja e ofertave dhe përzgjedhja e kompanisë. E njëjta ka qenë në ekskurzionin e organizuar pasiqë ka qenë kujdestare e klasës dhe se ka shtuar se akomodimi ka qenë i mirë – të gjithë nxënësit kanë qenë të vendosur në një hotel i cili e ka patur edhe bazenin vetëm për nxënësia, ka pasë veturë speciale për të iu dhënë ndihmë mjekësore eventuale nxënësve si dhe 24 orë në dispozicion mjekun, përafërsisht 60 nxënës kanë udhëtuar pa pagesë, fëmijët e dëshmorëve, kujdestarët e klasave dhe me ndihma sociale. E ka patur të organizuar muzikën e gjallë me qëllim që nxënësit mos të largohen nga hoteli, i është përmbajtur itinerarit të propozuar dhe se vizita në monumente historike për të gjithë nxënësit ka qenë gratis. Poashtu, kanë qenë edhe nxënësit e komunitetit boshnjak dhe se siguria ka qenë në nivel dhe se nuk kanë patur kurrfar ankese, as nga nxënësit, as nga prindërit e as nga ndonjë ofertues, dhe se paraprakisht para se të nisen për në ekskurzion kanë marrë edhe pëlqimin e prindërve.

I akuzuari V. H. në mbrojtjen e vet ka deklaruar se që nga viti 2009 deri në vitin 2014 ka qenë Drejtor i shkollës "I. P." dhe se si drejtor ka qenë pjesëmarrës i të gjitha procedurave rrethë organizimit të ekskurzionit. Ftesa për ofertë është publikuar dhe se kanë aplikuar gjithësejtë 4-5 kompani, afati për ofertë ka qenë deri më datën 03.10.2013 deri në ora 14,30 minuta. Me rastin e hapjes së ofertave nuk kanë qenë asnjë përfaqësues të kompanive ofertuese. Në ofert si kriter është përcaktuar oferta më e përshtatshme ekonomike çka nënkupton beneficinet nga kompanit, hoteli, madhësia e hotelit ka qenë shumë me rëndësi pasiqë përafërsisht kanë qenë 500 persona – nxënës së bashku me stafin dhe se për herë të parë kanë qenë edhe nxënësit e komunitetit boshnjak si dhe 3-4 profesor të këtij komuniteti. Komisioni pas përzgjedhjes e ka shpallur njoftimin në tabelën e njoftimeve të shkollës dhe se me atë njoftim është cekur se kompanitë që nuk janë përzgjedh kanë të drejtë ankese. Mirëpo, pranë drejtorisë së shkollës nuk ka patur kurrfarë ankese.

Në rastin konkret nuk është kontestuese se oferta e parë e shpallur nga shkollat për organizimin e ekskurzionit është anuluar nga DKA-ja për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas udhëzimit administrativ dhe se pastaj për shkak të konfliktit të interesit drejtori i DKA-së N. Ç. ka autorizuarin drejtorin e shkollës që të mirret me këtë çështje.

Kontestuese është se me përzgjedhjen e kompanisë "B." të akuzuarit a e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen sipas dispozitivit nën I të aktakuzës apo jo.

Konformë nenit 422 par.l. të KP personi zyrtar i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tija me qëllim që të përfitoi çfardo dobie për vehte ose për personin tjetër apo që ti shkaktoi dëm personit tjetër ose që seriozisht ti shkel të drejtat e personit tjetër kryen veprën penale të lartëcekur për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej 6 muajë deri në 5 vjetë.

Në bazë të lartëcekurave pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarëve I. B., R. E., I. M., H. M., S. B., S. B. 1, Sh. Sh., N. D. – A. dhe V. H., nuk krijohen elementet qenësore të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.l. lidhur me nenin 31 të KP, pasi që prokuroria nuk ka qenë në gjendje që të ofroi prova për fajsinë e të akuzuarëve-se të akuzuarit me veprimet e tyre, duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalojnë kompetencat e tyre ose nuk i përmbushin detyrat zyrtare të tyre me qëllim që ti shkaktojnë dëm personit tjetër ose që seriozisht ti shkelin të drejtat e personit.

Kjo nga fakti se me asnjë provë bindëse nuk u vërtetua se këtu të akuzuarit i kanë dëmtuar nxënësit për nga 23 Euro, respektivisht në dëm të përgjithshëm prej 10.603 Euro, pasi që askush as nxënësit e as prindërit nuk janë ankuar në këtë drejtim. Përkundrazi preferenca e tyre ka qenë për kompaninë „B.“ për shkak të sigurisë së nxënësve dhe kushteve të ofruara. Poashtu me asnjë provë bindëse gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetua se këtu të akuzuarit ia kanë shkelur të drejtat e kompanisë „Sh.“ nga Suhareka. Të akuzuarit kanë vepruar në tërësi sipas ofertës së shpallur dhe kriterëve të ofertës, ku si kriter është paraparë që të zgjidhet ofertuesi më i përshtatshëm, e të cilin e kanë zgjedhur edhe duke marrë parasysh kushtet e ofruara nga kompania e përzgjedhur.

Nga ana tjetër kompania „Sh.“ nuk ka mundur dhe nuk është dëmtuar, ashtu siq ka cekur përfaqësuesi i tij E. V. gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe që ka kërkuar kompenzimin e dëmit në shumën prej 15.000 Euro, pasi që kjo sipas gjykatës është dëm i syzozuar, e jo real. Kjo nga arsyeja se kompania „Sh.“ si dhe kompanitë tjera i janë përgjegjor ftesës së shpallur për ofertë dhe se mospërzgjedhja e tyre nuk do të thotë apriori se edhe janë të dëmtuar. Akuza pretendon se i janë shkelur të drejtat e kompanisë „Sh.“ nga Suhareka pasi që nuk është zbatuar kriteri i ftesës për ofertë për përzgjedhjen e kompanisë turistike më të përshtatshme ekonomike. Ky fakt nuk qëndron, pasi që është përzgjedhur kompania më e favorshme ekonomike e cila ka qenë edhe si kriter sipas ofertës e jo kompania më e lirë ashtu siq ka pretenduar gjatë shqyrtimit përfaqësuesi i kompanisë, se ka qenë kompania me ofertë më të lirë, pasi që kjo sipas ofertës nuk ka qenë kriter për përzgjedhjen e kompanisë. Nga ana tjetër kompanitë të cilat nuk janë përzgjedhur kanë patur të drejtë që të ankohen, sipas njohtimit të lartëcekur të shpallur në tabelën e njoftimeve të shkollës, mirëpo, asnjëra prej kompanive nuk është ankuar, e as kompania „Sh.“. Nga ana tjetër të kënaqur kanë ngelur nxënësit dhe prindërit të cilët poashtu nuk kanë patur kurrfarë ankese në ekskurzionin e organizuar nga ana e kompanisë së përzgjedhur „B. R.“. Nëse qëllimi i ekskurzionit për prindërit pikë së pari ka qenë siguria e fëmijëve të tyre, atëherë edhe kjo është arritur dhe se gjatë ekskurzionit nuk ka patur kurrfarë probleme.

Sa i përket dispozitivit nën II të aktakuzës me të cilën i vëhet në barrë të akuzuarit V. H. kryerja e veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare nga neni 422 par.l. të KP se në cilësi të drejtorit të Shkollës së mesme „I. P.“ në Prizren më datën 03.10.2013 në emër të Shkollës së mesme ekonomike të lartë „I. P.“ në Prizren me

kompaninë turistike "B. R." nga Prizreni të cilën e përfaqëson I. U. lidh kontratën me nr. të protokollit ... / .. për shkuarjen në ekskurzion të kësaj shkolle edhe sipas ftesës për ofertë të publikuar në gazetën "K. S." afati për shqyrtimin e ofertave ka qenë deri më datën 03.10.2013 dhe se në këtë mënyrë i tejkalon kompetencat duke i shkaktuar dëm kompanisë turistike "Sh." nga Suhareka dhe seriozisht i shkel të drejtat e kësaj kompanie, edhe në këtë drejtim prokuroria nuk ka qenë në gjendje që të ofroi prova për fajsinë e të akuzuarit, se me veprimet e tij, duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i ka tejkalu kompetencat e veta ose nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare me qëllim që ti shkaktoj dëm personit tjetër ose që seriozisht ti shkel të drejtat e personit. Kjo nga fakti se nga kontrata e lartpërmendur për transportimin e nxënësve vërtetohet se është nënshkruar më datën 04.10.2014 nga ana e drejtorit të shkollës V. H. , përfaqësuesit të kompanisë "B. R." dhe kryetarit të këshillit drejtues, që do të thotë se kontrata është nënshkruar pas skadimit të afatit të paraparë për shqyrtimin e ofertave pasiqë sipas ftesës për ofertë hapja- shqyrtimi i ofertave është bërë me datën 03.10.2013.

Andaj, edhe në këtë drejtim është mendimi i gjykatës se i akuzuari V.H. me veprimet e veta nuk i ka tejkalu kompetencat e veta, nuk i ka shkaktuar dëm personit tjetër dhe nuk i ka shkel të drejtat e personit tjetër. Kjo nga arsyeja se në rastin konkret nuk ka të dëmtuar. Nxënësit vet e kanë bërë pagesën e udhëtimit të ekskurzionit me të ardhura vetanake duke paguar çmimin prej 108 Euro dhe se në këtë drejtim nuk ka patur kurrfarë ankese as nga nxënësit e as nga prindërit. Nga ana tjetër kompania "Sh." nuk ka mundur se si të dëmtohet kur kompania në fjalë ka marr pjesë në ofertë si kompanitë tjera ofertuese -"Zh. T." , "A." e që nuk janë përzgjedhur. Poshtu sipas bindjes dhe vlerësimit të gjykatës kompanisë në fjalë nuk i janë shkëlur kurrfarë të drejta me nënshkrimin e kontratës së lartëcekur në mes të shkollës dhe kompanisë "B. R.", pasiqë kjo kontratë është nënshkruar pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave të ofertuesve. Nga ana tjetër kompania "Sh." aqë ka qenë e painteresuar saqë nuk ka marrë pjesë në hapjen e ofertave e as që e ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës në njohtimin e shpallur në tabelën e njohtimeve të shkollës me të cilin njohtim janë informuar se cila kompani është përzgjedhur. Andaj, bazuar në këto fakte të parashtuara, gjykata edhe erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit V. H. nuk formohen elementet qenësore të veprë penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KP. Kjo nga arsyeja se kjo vepër penale kryhet me dashje, e në rastin konkret kjo nga provat e ofruara nga prokuroria nuk është vërtetuar.

Andaj, në mungesë të provave që do ta vërtetonin faktin e fajësisë së të akuzuarve, pasiqë një gjë e tillë nuk është provuar me asnjë provë relevante dhe bindëse, gjykata morri aktgjykim lirues dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, sepse nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarëve formohen elementet qenësore të veprave penale për të cilat janë akuzuar në bazë të aktakuzës.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 454 par.1 të KPP.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti për krime të rënda**  
**Më dt.06.06.2016. P.nr.181/15**

**Proçesmbajtësja**  
**Sheqere Braha**

**Kyetarja e trupit gjykues**  
**Ajser Skenderi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet të kësaj gjykate.